



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 24/3 Prot.

Tiranë, më 24.03.2016

**V E N D I M**

**Nr. 29, datë 24.03.2016**

**Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,  
filluar me Urdhrin nr. 953/1 prot., datë 21.01.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me paligjshmërinë e emërimit në shërbimin civil, të punonjësit \*\*\*\*\* , në Ministrinë e Mbrojtjes.

**VËREJ SE :**

Në zbatim të Urdhrit të verifikimit nr.953/1 prot., të datës 21.01.2016, pasi u trajtua informacioni i regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 953 prot., datë 29.12.2015, ka nisur procesi i verifikimit në lidhje me paligjshmërinë e emërimit në shërbimin civil, të punonjësit \*\*\*\*\* , në Ministrinë e Mbrojtjes.

Nga aktet e administruara rezulton se, punonjësi \*\*\*\*\* është emëruar si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin "Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes", me Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 130/5, datë 24.02.2014, "Për marrjen në punë me kontratë".

Në vijim konsatohet se, gjatë periudhës së provës, siç rezulton nga formulari i vlerësimit të punës i datës 21.11.2014, punonjësi \*\*\*\*\* ka përmbushur me korrektësi, përgjegjësitë e pozicionit të punës dhe ka ndjekur në mënyrë të suksesshme programet e trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civilë në periudhë prove, të organizuar nga Shkolla Shqiptare e

Administratës Publike (ASPA), në periudhën 15 tetor deri 28 tetor 2014, duke u vlerësuar me 25 pikë nga 28 të mundshme.

Mbi këtë bazë, me aktin nr. 3875 prot., datë 29.04.2015 të eprorit direkt, punonjësi \*\*\*\*\* është konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Aseteve Fikse dhe Veprimtarive, në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes*”.

Në vijim, me shkresën nr. 3949/1 prot., datë 05.05.2015, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, është njoftuar Departamenti i Administratës Publike, për konfirmimin e këtij punonjësi si nëpunës civil, në Ministrinë e Mbrojtjes .

Nga sa më sipër, vlerësoj se informacioni i paraqitur pranë Komisionerit, me shkresën nr. 953 prot, datë 29.12.2015, në të cilën përcaktohet se Ministria e Mbrojtjes, ka emëruar me kontratë punonjësin \*\*\*\*\* në muajin prill 2014, dy muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit, nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, rezulton i pambështetur në provat e administruara, për arsye se :

Nëpunësi \*\*\*\*\* , është emëruar si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes*”, me Urdhrin e Ministrisë së Mbrojtjes nr. 130/5, në datën, 24.02.2014, “*Për marrjen në punë me kontratë*”. Data e fillimit të marrëdhënieve financiare është pikërisht, data 24.02.2014, e vërtetuar kjo nga Urdhri Nr. 130/8 datë 12.04.2014 “*Për një ndryshim në Urdhrin nr. 130/5, datë 24.02.2014*”, i Ministrisë së Mbrojtjes dhe list pagesat përkatëse, nga ku rezulton se fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e ka gjetur punonjësin \*\*\*\*\* të punësuar në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes*”.

Në pikën 4, të nenit 67, të ligjit të sipërpërmendur, përcaktohet se: “*Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji*”.

Në analizë të dispozitës së mësipërme, Komisioneri vëren se, dita e fillimit të periudhës së provës, në datën 24.02.2014, e cila përkon me datën e emërimit të tij, është përcaktuar gabim, pasi në rastin konkret kjo llogaritje duhej të fillonte në datë 26.02.2014. Por, pavarësisht këtij fakti, në thelb institucioni ka vepruar drejt, duke e përfshirë këtë nëpunës në periudhën e proves, si një e drejtë e këtij punonjësi që rrjedh nga ligji, e duke zbatuar detyrimet që parashikon neni 24, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në aktet e administruara rezulton se nëpunësi \*\*\*\*\* me të drejtë, është konsideruar nëpunës civil në periudhë prove, prej dt. 24.02.2014 deri në 24.02.2015.

Nisur nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se emërimi dhe procedura e ndjekur, si për emërimin dhe konfirmimin e këtij nëpunësi civil nga ana e njësisë përgjegjëse, është bërë konform ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, prandaj nuk është i nevojshëm

investimi apo ndërhyrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për rregullimin e ligjshmërisë.

**Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 16, pika 6, dhe 34, pika 1, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**VENDOSA:**

1. Përfundimin e procedimit administrativ, kryer mbi bazën e Urdhrit të Verifikimit nr.953/1 prot., datë 21.01.2016, “Për verifikimin e informacionit në lidhje me, paligjshmërinë e emërimit në shërbimin civil, të punonjësit \*\*\*\*\*”, në Ministrinë e Mbrojtjes”.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Ministria e Mbrojtjes dhe Departamenti i Administratës Publike .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**